



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 04, datë 20.01.2020

**PËR SHPALLJEN E VENDEVE TË LIRA PËR KANDIDATËT PËR  
PROKUROR**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenet 35/3 dhe 39/1 të Ligjit Nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe neneve 164/8, 166/2, 189/1/b të Ligjit 115 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës;

**V E N D O S I:**

1. Të shpallë si vende të lira për emërimin e magjistratëve të profilit prokuror, të diplomuar në vitin akademik 2018 — 2019, vendet e mëposhtme:
  - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë - 2 vende;
  - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë - 2 vende;
  - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat - 1 vend;
  - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë - 1 vend;
  - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër - 1 vend;
  - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër - 1 vend;
  - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë - 1 vend;
  - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë - 1 vend
2. Të ftojë magjistratët e profilit prokuror të diplomuar në vitin akademik 2018 — 2019 të paraqesin një kërkesë me shkrim ku të tregojnë parapëlqimin e tyre për 3 (tre) prej vendeve të përmendura në pikën e parë të këtij Vendimi, sipas radhës së parapëlqimit, jo më vonë se 2 javë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

GENT I BRAHIMI

